

VENDIM
Nr. 153, datë 29.2.2012

**PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE
STRATEGJIKË PËR SHITJEN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË AKSIONARE “HEC
ULËZ-SHKOPET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar dhe të neneve 3, 5 e 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, sh.a., me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “Hec Ulëz-Shkopet”, të jenë sipas shtojcës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për kryerjen e procedurave të privatizimit të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare “Hec Ulëz-Shkopet”, në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1

**PROCEDURAT E TENDERIT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E INVESTITORËVE
STRATEGJIKË PËR PRIVATIZIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA
SHTETI, QË PËRBËN 100% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË “HEC ULËZ-SHKOPET” SHA, 2012**

Procedurat dhe kriteret e këtij tenderi “Procedurat e tenderit” janë përgatitur në përputhje me nenin 3 dhe 8 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet sh.a.” “Hec Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a.” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

1. HYRJE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë “QSH” ka ndërmarrë një sërë iniciativash në sektorin e energjisë, përfshirë dhe procesin e liberalizimit dhe privatizimit të tregut të energjisë, si rrjedhojë e aderimit në traktatin që themelon Komunitetin e Energjisë, nënshkruar më 25 tetor 2005 në Athinë.

Masat kryesore të ndërmarra nga QSH, për liberalizimin e tregut të energjisë, midis të tjerave janë:

- Shkëputja nga KESH-i e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST);
- Shkëputja nga KESH-i e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Vendosja e rregullave të reja liberalizuese për tregun e energjisë, duke miratuar modelin e ri të tregut të energjisë (vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19 mars 2008 “Mbi miratimin e modelit

të tregut të energjisë”) dhe Rregullat e reja të Tregut të Energjisë (vendimi i Entit Rregullator ERE nr. 68, datë 23 qershor 2008);

- Privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), i shkëputur nga KESH-i;

QSH-ja planifikon të zhvillojë më tej strategjinë e nisur prej saj, duke tërhequr investime të mëtejshme të huaja në sektorin shqiptar të energjisë, dhe veçanërisht në projektet e prodhimit të energjisë hidrike.

QSH-ja, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “METE” të Republikës së Shqipërisë, ose “Shitësi”, dëshiron të privatizojë 100% të kapitalit të shoqërisë aksionare “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. në vijim “Shoqëria objekt”, e cila ka selinë e regjistruar në Mat, Shqipëri.

Shoqëria objekt është e angazhuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga burime hidrike dhe të shitjes së energjisë elektrike. Privatizimi i shoqërisë objekt do të realizohet me anë të shitjes së njëqind për qind (100%) të aksioneve të kapitalit të saj, të zotëruar nga METE, në vijim “Paketa aksionare”, në favor të investitorit strategjik të përzgjedhur sipas këtyre procedurave të tenderit, në vijim “Projekti”.

Me synimin për të tërhequr investitorët strategjikë optimalë operimin dhe zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë objekt, QSH-ja ka vendosur të nisë procedurat e tenderit të hapur ndërkombëtar, “Procesi i tenderimit” për lidhjen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve”, midis METE-s dhe investitorit strategjik të përzgjedhur sipas këtyre procedurave të tenderit.

METE dhe/ose QSH-ja, sipas rastit, rezervojnë të drejtën që në çdo kohë të rishikojnë apo të anulojnë procesin e tenderimit për shoqërinë objekt, ose të refuzojnë çfarëdo rekomandimi të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave ose të mos lidhin marrëveshje me asnjërin nga ofertuesit, pa asnjë kosto e pa asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve për METE dhe/ose QSH, apo çdo ministrie, për komisionin e vlerësimit të ofertave, ose ndonjë përfaqësues të tyre, apo çdo anëtar apo personi tjetër, edhe nëse ka pasur dëme apo shpenzime të kryera, si dhe të rishikojnë procedurat e tenderit dhe/ose udhëzimet për ofertuesit.

Gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës, deri në ekzekutimin dhe mbylljen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, asnjë ofertues nuk do të ketë asnjë të drejtë në lidhje me shoqërinë objekt, si rezultat i paraqitjes së një oferte dhe/ose pjesëmarrjes në procesin e tenderimit dhe as METE as QSH, nuk kanë asnjë detyrim të lidhin një marrëveshje shitblerjeje aksionesh.

2. NJOFTIMI PUBLIK

METE do të publikojë një njoftim për hapjen e procesit të tenderimit në të paktën tri gazeta me qarkullim ndërkombëtar. Afatet kohore për nisjen e publikimit do të miratohen nga METE së bashku me “Udhëzimet për ofertuesit”. Publikimi i njoftimit për fillimin e procesit të tenderimit do të kryhet në përputhje me kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

3. RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË TENDERIMIT

3.1 Ligji i zbatueshëm

Procesi i tenderimit do të kryhet dhe do të rregullohet duke zbatuar procedurat e tenderit të përcaktuara sipas këtij dokumenti, si dhe nga udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat), të miratuara nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3.2 Tender ndërkombëtar

Procesi i tenderimit është një tender i hapur ndërkombëtar me një fazë dhe botohet në të paktën tri gazeta ndërkombëtare. Procesi i identifikimit dhe pranimit të investitorëve strategjikë bëhet në përputhje me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të miratuara nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3.3 Gjuha

Gjuha e procesit të tenderimit do të jetë gjuha angleze dhe gjuha shqipe. Propozimet teknike dhe

financiare, të paraqitura nga ofertuesit, si dhe korrespondenca dhe dokumentet që i përkasin ofertës duhet të paraqiten në anglisht dhe të përkthyer dhe të noterizuara, me përjashtimin që çfarëdo informacion të paraprintuar, që mund të paraqitet nga ofertuesi në një gjuhë tjetër, por me kusht që pjesët e rëndësishme përkatëse, të jenë të shoqëruara me përkthimin në gjuhën angleze, vërtetuar në vendin e origjinës së ofertuesit.

3.4 Pranimi i kushteve të procesit të tenderimit

Paraqitja e një oferte nga një ofertues nënkupton njohjen dhe pranimin e plotë të të gjitha kushteve të përcaktuara në këto procedura tenderi dhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat e saj), si dhe të të gjitha përgjegjësiave që rrjedhin në rast se shpallet si ofertues fitues (siç përcaktohet në paragrafin 9.5.1).

3.5 Përkufizimet

Sa herë që përdoren në këto procedura tenderi, përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar si më poshtë, bashkëlidhur, nëse një term nuk është përkufizuar në këto procedura tenderi, atëherë termi do të ketë kuptimin e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të cilat miratohen nga METE. Në rastet e konfliktit midis termave të përcaktuar në këtë dokument dhe të njëjtave terma të përshtatur ndryshe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përshtatur në këto procedura tenderi do të mbizotërojnë dhe do të zbatohen, gjithashtu, edhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Përkufizimet janë:

“Afati i paraqitjes së ofertave” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 7.2.1.

“Autoritetet” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.4.

“Çmimi i ofruar” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.10.

“Kalendari i parashikuar” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.5.

“Konsorcium” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Kryesues” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“METE ose “Shitësi” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Njoftim për tërheqje” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 7.4.

“Ofertë” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Oferta financiare” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.3.

“Oferta teknike” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.2.

“Ofertuesi fitues” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 9.5.1.

“Ofertuesit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 4.1.

“Paketa aksionare” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Periudha e vlefshmërisë së ofertave” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.2.1.

“Përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 5.2.

“Procedurat e tenderit”, procedurat për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë objekt.

“Procesi i tenderimit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Projekti” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“QSH” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Raporti i vlerësimit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 9.2.

“Sigurimi i ofertës” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 6.1.11.

“Shpenzimet e ofertës” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 3.6.

“Shoqëria objekt” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1.

“Udhëzime për ofertuesit” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 2.

3.6 Kostot

Ofertuesit do të përballojnë të gjitha kostot në lidhje me kryerjen e verifikimeve (*due diligence*) të tyre dhe përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tyre, dhe pjesëmarrjen e ofertuesit në procesin e tenderimit, “shpenzimet e ofertës” përfshirë, pa kufizim, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përfshirjen e ofertuesit në:

- Grumbullimin e të gjithë informacionit tjetër, përfshirë verifikimet (*due diligence*) e ofertuesit;

- Intervistat;
- Përgatitjen e përgjigjeve ndaj pyetjeve ose kërkesave për sqarim nga METE;
- Përgatitjen e kërkesave të ofertuesit gjatë procesit të sqarimit; dhe
- Diskutimet për marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve.

METE nuk do të jetë përgjegjëse dhe nuk do të ketë detyrimin të paguajë asnjë shpenzim për ofertën të kujt do ofertuesi, pavarësisht nga kryerja apo ndërprerja e procesit të tenderimit.

4. OFERTUESIT

4.1 Ofertuesit e ftuar

Pjesëmarrja në procesin e tenderimit është e hapur për të gjithë investitorët e interesuar, të cilët janë investitorë strategjikë, sipas përkufizimit vijues dhe kanë shprehur rregullisht interesin e tyre për të marrë pjesë në procesin e tenderimit sipas afateve dhe kushteve të këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë shtojcat) “Ofertuesit”.

METE do të rezervojë të drejtën t’i dërgojë ftesa për ofertë vetëm atyre investitorëve të interesuar, të cilët pasi kanë shprehur interesin e tyre për të marrë pjesë në procesin e tenderimit, kanë treguar që përmbushin kriteret e mëposhtme të kualifikimit:

1. Të jenë themeluar (në përputhje me legjislacionin që i zbatohet themelimit të tyre) si person juridik, me personalitet ligjor të ndryshëm nga ai i ortakëve/aksionarëve të tij;
2. Të kenë aftësi paguese dhe të mos jenë në procese falimentimi apo në procedura likuidimi;
3. Të zotërojnë burime njerëzore, teknike, profesionale dhe eksperiencë organizative në operimin e hidrocentraleve - një ofertues, i cili zotëron/operon një ose më shumë hidrocentrale, me një fuqi të instaluar, veçmas ose të kombinuar prej të paktën 15 MW, konsiderohet që e përmbush këtë kriter;
4. Të zotërojnë burimet financiare për operimin e hidrocentraleve - një ofertues konsiderohet se e plotëson këtë kriter nëse kapitalet e veta, siç rezulton nga llogaritë financiare të vitit të fundit financiar, janë të paktën të barabarta me 25 milionë euro (ose ekuivalenti në një monedhë tjetër);
5. Të ketë një reputacion rajonal dhe/ose ndërkombëtar si operator në tregun e energjisë.

Forma dhe përmbajtja e dokumenteve që vërtetojnë përmbushjen e këtyre kriterëve do të miratohen nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit. Vlerësimi i këtyre kriterëve dhe lëshimi i ftesës për ofertë do të jetë në diskrecionin e plotë të METE-s.

Shprehja e interesit për të marrë pjesë në procesin e tenderimit mund të paraqitet, gjithashtu, në formën e konsorciumit midis disa investitorëve të interesuar, duke pasur parasysh që një kopje e nënshkruar e marrëveshjes së konsorciumit duhet t’i dorëzohet METE-s, së bashku me dokumentacionin përkatës (siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit) për secilin anëtar, në lidhje me kriteret e mësipërme.

Për qëllim të këtyre procedurave tenderimi, “Konsorcium” do të përkufizohet një marrëveshje *joint-venture*, konsorcium ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje e ngjashme për bashkimin e përkohshëm të ndërmarrjeve, pavarësisht nga titulli apo cilësimi ligjor në bazë të legjislacionit të zbatueshëm në vendin e origjinës nga vjen ky bashkim, i cili ka si objekt pjesëmarrjen e përbashkët në procesin e tenderimit dhe paraqitjen e përbashkët të një oferte për shoqërinë objekt. Anëtarët e konsorciumit nuk do të lejohen të ndryshojnë kushtet e marrëveshjes së konsorciumit gjatë procesit të tenderimit, dhe më tej, sipas marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, pa miratimin paraprak me shkrim të METE-s, i cili do të jetë në diskrecionin e saj.

Marrëveshja e konsorciumit duhet të tregojë anëtarin, i cili do të jetë “Kryesues” i konsorciumit, i cili do të ketë shumicën e pjesëmarrjes në konsorcium, dhe të cilit do t’i adresohet METE për të gjitha qëllimet gjatë procesit të tenderimit. Njoftimet e METE-s ndaj kryesuesit, dhe përgjigjet e kryesuesit do të jenë të detyrueshme edhe për anëtarët e tjerë të konsorciumit.

Çfarëdo ndryshimi i kushteve të marrëveshjes së konsorciumit gjatë procesit të tenderimit, pa miratimin paraprak me shkrim nga ana e METE-s, do të shkaktojë skualifikimin e konsorciumit dhe të anëtarëve të tij.

Nëse shprehja e interesit për të marrë pjesë në procesin e tenderimit është paraqitur si konsorcium, atëherë çdo anëtar i konsorciumit duhet të përmbushë të paktën kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi 4.1, me kusht që konsorciumi në tërësi, duhet të përmbushë të gjitha kriteret nga 1 në 5 të këtij paragrafi 4.1.

Ofertuesit, të cilët janë ftuar nga METE për të marrë pjesë individualisht në procesin e tenderimit, lejohen, gjithashtu, të paraqesin një ofertë si konsorcium, me kusht që përpara afatit për paraqitjen e ofertave, ofertuesi i ftuar, i cili do të jetë kryesuesi i konsorciumit, duhet të paraqesë te METE njoftimin me shkrim për krijimin e konsorciumit, së bashku me një kopje me shkrim të marrëveshjes së konsorciumit dhe të dokumentacionit përkatës (siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit), për anëtarët e konsorciumit në lidhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të paragrafit 4.1. METE do të ftojë zyrtarisht konsorciumin, nëse të gjitha kushtet e mësipërme janë plotësuar, dhe pas lëshimit të një ftese të re për konsorciumin, ftesa e mëparshme e lëshuar nga METE për ofertuesit individualë do të zhvlerësohet, pa cenuar vlefshmërinë e veprimeve, dokumenteve dhe korrespondencave të tjera të mëparshme, të kryera gjatë procesit të tenderimit me ofertuesin individual të ftuar më parë. Konsorciumet midis ofertuesve të ftuar individualisht më parë nga METE, nuk do të pranohen.

Vetëm ofertuesit që plotësojnë këto kritere, dhe të cilët janë ftuar nga METE për të marrë pjesë në procesin e tenderimit, individualisht apo si konsorcium, do të pranohen të paraqesin një “Ofertë” sipas paragrafëve 6 dhe 7.

4.2 Kufizimet

Çdo investitor i interesuar merr pjesë në procesin e tenderimit si një ofertues i vetëm (ose si anëtar i një konsorciumi të vetëm) dhe secili ofertues (ose konsorcium) mund të paraqesë vetëm një ofertë (siç është përshkruar në paragrafin 6 dhe 7). Një investitor i interesuar do të konsiderohet si pjesëmarrës në procesin e tenderimit kur:

- a) është ftuar nga METE për të qenë një ofertues; ose
- b) është anëtar i një konsorciumi, i cili është ftuar nga METE për të qenë ofertues.

5. DOKUMENTET E TENDERIT

5.1 Përmbajtja e dokumenteve të tenderit

Dokumentet e tenderit përfshijnë:

1. Ligjin nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë”;
2. Ligjin nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz- Shkopet sh.a.”, “Hec Tiranë, Lanabregas sh.a.” dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.” dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet sh.a.” dhe “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a.”;
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton këto procedura tenderi;
4. Udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) të miratuara me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
5. Memorandumi informativ (CV) për shoqërinë;
6. Ekstrakti i regjistrit tregtar për “Hec Ulëz-Shkopet sh.a.”;
7. Akti i themelimit/statuti i “Hec Ulëz-Shkopet sh.a.”;
8. Bilanci dhe raporti i auditimit të “Hec Ulëz-Shkopet sh.a.” për vitin 2011.

Secili ofertues do të verifikojë nën përgjegjësinë e tij të gjitha udhëzimet, kushtet dhe kriteret, format, specifikimet dhe çdo informacion tjetër të përfshirë në këto procedura tenderi dhe në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat). Nëse ofertuesi:

- a) Nuk arrin të paraqesë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga këto procedura tenderi dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat); ose
- b) Paraqet një ofertë, e cila nuk përputhet në thelb me kushtet dhe kriteret e këtyre procedurave të tenderit dhe të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Atëherë këto veprime janë nën riskun e ofertuesit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave mund të deklarojë ofertën në mospërputhje me këto procedura tenderi dhe udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat); dhe mund ta refuzojë atë.

Një kopje e të gjitha dokumenteve të tenderit do t’i jepet çdo ofertuesi (sipas përkufizimit të paragrafit 4), i cili ka nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti dhe ka paguar tarifën e verifikimeve (*due diligence fee*) sipas udhëzimeve për ofertuesit të miratuara nga METE. Ofertuesit, të cilët nuk

nënshkruajnë marrëveshjen e konfidencialitetit dhe nuk paguajnë tarifën e verifikimeve, nuk do të marrin dokumente apo informacione, siç shpjegohet hollësisht në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat), të cilat përmbajnë informacion konfidencial mbi shoqërinë objekt.

5.2 Sqarime mbi dokumentet e tenderit

Një ofertues, i cili kërkon ndonjë sqarim apo ndryshim të udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) mund të njoftojë METE-n me *e-mail* në adresën e përcaktuar në udhëzimin për ofertuesit dhe një kopje të saj te konsulenti IFC albaniahpps@ifc.org. Në të njëjtën mënyrë, nëse një ofertues mendon që ndonjë parashikim i rëndësishëm i udhëzimeve për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) është i papranueshëm, mund ta ngrejë këtë çështje në çdo kohë, përpara afatit për paraqitjen e ofertave, siç specifikohet në kalendarin e parashikuar (përcaktuar më poshtë në paragrafin 5.5) pa paragjykuar të drejtën e diskrecionalitetit të METE-s për ta pranuar ose jo këtë kërkesë për ndryshim.

Çdo kërkesë për sqarim apo ndryshim të udhëzimeve të ofertës (përfshirë dhe shtojcat) duhet të merret (në mënyrën e përshkruar në paragrafin 5.2) jo më vonë se në datën e përcaktuar në kalendarin e parashikuar. Kopjet elektronike të përgjigjeve (nëse ka) përfshirë dhe një shpjegim të çështjes, por jo identifikimin e burimit “Përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin”, do t’i dërgohet nga METE (apo nga personi i autorizuar nga METE) të gjithë ofertuesve. Nëse pyetje të ngjashme apo të përsëritura bëhen nga ofertuesit, këto pyetje mund të listohen si një e vetme dhe METE mund t’i përgjigjet kësaj pyetjeje vetëm një herë. Asnjë përgjigje dhe/ose informacion ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin e dhënë me gojë apo me shkrim do të jetë detyruese për palët. Vetëm marrëveshja e shitblerjes së aksioneve dhe shtojcat e saj, nëse është lidhur në mënyrë të rregullt, do të ketë forcën e ligjit dhe do të jetë detyruese për palët.

METE do të organizojë 1 (një) raund komentesh, në mënyrë që ofertuesit të kenë mundësinë që të paraqiten dhe të diskutojnë me METE-n në lidhje me komentet e tyre me shkrim mbi udhëzimet e ofertës, përfshirë dhe marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve.

5.3 Ndryshimet e udhëzimeve të ofertës (përfshirë dhe shtojcat)

Në çdo moment para afatit për paraqitjen e ofertave (siç përcaktohet në paragrafin 7.2) METE mundet që, për çdo arsye, qoftë me iniciativën e saj apo si përgjigje ndaj sqarimeve të kërkuara nga një ofertues, të ndryshojë udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat). Asnjë komunikim tjetër i çfarëdo lloji, përfshirë, por pa u kufizuar, përgjigjet ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin, nuk do të ndryshojë udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat).

Ndryshimet do t’i njoftohen me shkrim të gjithë ofertuesve dhe dokumentet e ndryshuara do të konsiderohen dokumentet e zbatueshme për qëllimet e procesit të tenderimit.

Në mënyrë që t’i jepet ofertuesve koha e arsyeshme për të marrë parasysh ndryshimet në përgatitjen e ofertave të tyre, METE mundet, që në diskrecionin e saj, të shtyjë afatin për paraqitjen e ofertave (siç përcaktohet në paragrafin 7.2), në këtë rast, METE do të njoftojë më shkrim të gjithë ofertuesit për shtyrjen e këtij afati.

5.4 Informacioni i dhënë nga autoritetet/verifikimet e ofertuesit

Secili ofertues është i vetmi përgjegjës për kryerjen e kërkimeve të pavarura, verifikimeve (*due diligence*) dhe çdo punë apo hetimi dhe për marrjen e çdo këshillimi tjetër të pavarur, me shpenzimet e tij, për përgatitjen e ofertës së tij dhe negocimit dhe përfundimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Asnjë përfaqësim apo garanci, e shprehur ose e nënkuptuar, nuk jepet dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi të asnjë lloji për METE-n stafin e saj apo agjentët e saj “Autoritetet” apo këshilluesit e tyre, punëmarrësit, konsulentët apo agjentët, për plotësinë apo saktësinë e çdo informacioni të përfshirë në dokumentet e ofertës ose në përgjigjen ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin, ose çdo informacion tjetër të dhënë gjatë procesit të tenderimit apo gjatë negociatave për marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve. Autoritetet dhe këshilluesit e tyre, punëmarrësit, konsulentët dhe agjentët nuk do të jenë përgjegjës ndaj asnjë personi apo shoqërie, si rezultat i përdorimit të ndonjë informacioni të përfshirë në dokumentet e tenderimit, në përgjigje ndaj pyetjeve mbi dokumentacionin apo dhënë gjatë procesit të tenderimit ose gjatë negociatave për përfundimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Ofertuesit nuk do të mbështeten mbi asnjë deklaram të bërë me gojë nga autoritetet, këshilluesit, punëmarrësit, konsulentët dhe agjentët e tyre.

Të gjithë ofertuesit, para se të paraqesin ofertat e tyre, duhet të kontrollojnë të gjitha kriteret për

përputhshmërinë me legjislacionin për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe kriteret e tjera, të cilat i zbatohen shoqërive tregtare, të cilat dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari tregtare në Shqipëri. Ofertuesit janë përgjegjës të vetëm për të gjitha çështjet në lidhje me aftësinë e tyre ligjore për të operuar në juridiksionin nën të cilin zhvillohet procesi i tenderimit.

Çdo informacion i dhënë nga autoritetet gjatë zhvillimit të verifikimeve, do të jetë objekt i marrëveshjes së konfidencialitetit të nënshkruar nga të gjithë ofertuesit.

5.5 Afatet kohore

Në këto procedura tenderi një ditë pune zyrtare, përveçse nëse është parashikuar ndryshe në dokumentit standarde të tenderit, do të jetë një nga ditët e javës, përjashtuar të shtunat dhe të dielat dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Një kalendar i parashikuar për procesin e tenderimit, është përfshirë në udhëzimet për ofertuesit “Kalendar i parashikuar”.

METE mundet që në diskrecionin e saj dhe pa njoftim paraprak ndaj ofertuesve, të ndryshojë kalendarin e parashikuar dhe të njoftojë ofertuesit mbi këtë ndryshim.

Ofertuesit nuk do të mbështeten në asnjë mënyrë në kalendarin e parashikuar dhe METE nuk do të ketë asnjë përgjegjësi si pasojë e ndryshimeve të kalendarit të parashikuar.

6. OFERTAT: PËRGATITJA

6.1 Përgatitja e ofertave

6.1.1 Dokumentet përbërës të ofertës

Kur paraqitet një ofertë në përputhje me paragrafin 7, secili ofertues sipas përkufizimit të paragrafit 4, mund, pa qenë i detyruar, të paraqesë një ofertë në lidhje me “Hec Ulëz-Shkopet sh.a.”

Çdo e dhënë e rreme do të konsiderohet si e mjaftueshme për skualifikimin e ofertuesit (ose konsorciumit) dhe çdo zbulim, që ofertuesi ka paraqitur informacion të rremë ose informacion të mbajtur të fshehur në ofertën e tij, do të konsiderohet si shkak për zgjidhjen e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Ofertuesit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të procesit të tenderimit, pa bërë asnjë ndryshim të kushteve të tyre. Asnjë shënim mbi formatet e miratuara, përfshirë dhe ofertat teknike dhe financiare, nuk do të pranohet. Ofertat e kushtëzuara nuk pranohen.

Çdo ofertë e paraqitur si më sipër, duhet të përbëhet nga dokumentet e mëposhtme:

6.1.2 Oferta teknike

Propozimi teknik, i përbërë nga dokumentet e mëposhtme, së bashku “Oferta teknike”:

a) Formulari i aplikimit të ofertës sipas kërkesave të paragrafit 6.1.4;
b) Drafti final i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, me secilën faqe të inicializuar nga ofertuesi;

c) Prokurë përfaqësimi me formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas paragrafit 6.1.5;

d) Konfirmimi i kushteve teknike minimale sipas kërkesave të paragrafit 6.1.6;

e) Konfirmimi i kushteve minimale të punësimit, sipas kërkesave të paragrafit 6.1.7;

f) Deklarata e konfliktit të interesit sipas kërkesave të paragrafit 6.1.8;

g) Deklarata e komisioneve dhe shpërblimeve sipas kërkesave të paragrafit 6.1.9;

6.1.3 Oferta financiare

Propozimi financiar, i përbërë nga dokumentet e mëposhtme, së bashku “Oferta financiare”:

a) Formulari i ofertës financiare, sipas kërkesave të paragrafit 6.1.10 më poshtë;

b) Sigurimi i ofertës, me formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas paragrafit 6.1.11;

6.1.4 Formulari i aplikimit të ofertës

Forma dhe përmbajtja e formularit të aplikimit të ofertës do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.5 Prokurë përfaqësimi

Në ofertën teknike, çdo ofertues (ose nëse ofertuesi është një konsorcium, secili pjesëmarrës i konsorciumit) do të paraqesë një prokurë përfaqësimi me shkrim, e cila tregon që personi(at) që nënshkruajnë ofertën ka(në) autoritetin për të nënshkruar ofertën dhe, që oferta është detyruese për

ofertuesin (ose konsorciumin e tij) gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Forma dhe përmbajtja e prokurës së përfaqësimit do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.6 Kushtet minimale teknike

Në ofertën teknike, çdo ofertues duhet të konfirmojë angazhimin për të përmbushur kushtet minimale teknike për shoqërinë objekt, nëse ka, të cilat do të përcaktohen nga METE me miratimin e udhëzimeve për ofertuesit.

Kushtet minimale teknike do të përfshijnë përmbushjen e udhëzimeve të përgjithshme të IFC-së për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, si dhe udhëzimeve të posaçme të IFC-së për sektorin apo udhëzime ekuivalente të praktikës së mirë ndërkombëtare të pranuar nga IFC-ja, udhëzime, të cilat mund të aksesohen në faqen e internetit:

<http://www.ifc.org/ifcext/sustainability.nsf/Content/EHSGuidelines>.

Përmbajtja e kushteve minimale teknike për operimin e shoqërisë objekt, së bashku me deklaratën e përputhshmërisë, do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.7 Kushtet minimale të punësimit

Në ofertën teknike, çdo ofertues duhet të konfirmojë angazhimin për të përmbushur kushtet e pushimeve kolektive nga puna, të miratuara nga QSH-ja në lidhje me shoqërinë objekt.

Kushtet minimale të punësimit do të përfshijnë përmbushjen e standardeve të performancës 2 të IFC-së “Punësimi dhe kushtet e punës”, të cilat mund të aksesohen në faqen e internetit:

<http://www.ifc.org/ifcext/sustainability.nsf/Content/EHSGuidelines>.

Përmbajtja e kushteve minimale të punësimit për shoqërinë objekt, së bashku me deklaratën e përputhshmërisë, do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.8 Deklarata e konfliktit të interesit

Në ofertën teknike, secili ofertues (ose nëse ofertuesi është një konsorcium, secili pjesëmarrës i konsorciumit) do të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi konfliktin e interesit, në lidhje me çfarëdo konflikti interesi, të tanishëm, të mundshëm apo të ardhshëm, që ofertuesi (ose secili pjesëmarrës i konsorciumit) mund të ketë me procesin e tenderimit.

Forma dhe përmbajtja e deklaratës së konfliktit të interesit do të miratohen nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.9 Komisionet dhe shpërblimet

Në ofertën teknike, secili ofertues (ose nëse ofertuesi është një konsorcium, secili pjesëmarrës i konsorciumit) do të paraqesë informacion të detajuar, i cili liston të gjitha komisionet dhe shpërblimet, nëse ka ndonjë, të paguar ose për t’u paguar nga ofertuesi, agjentëve dhe/ose ndërmjetësve në lidhje me ofertën apo marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, së bashku me vlerën dhe valutën e paguar ose për t’u paguar dhe qëllimi i komisionit ose i shpenzimit. Nëse nuk ka pagesa komisionesh apo shpenzimesh, atëherë ofertuesi do ta pasqyrojë këtë informacion në ofertën e tij teknike.

Forma dhe përmbajtja e Deklaratës së Komisioneve dhe Shpërblimeve do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.10 Oferta financiare

Oferta financiare duhet të përmbajë çmimin e ofruar nga ofertuesi “Çmimi i ofruar” për blerjen e titullit ligjor të njëqind për qind (100 %) të aksioneve të kapitalit të shoqërisë objekt. Çmimi i ofruar duhet të shprehet si një vlerë fikse në euro, për t’u paguar nga fonde menjëherë të disponueshme, sipas kushteve dhe kriterëve të draftit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, në fuqi sipas miratimit të METE-s brenda afatit për paraqitjen e ofertave.

Në ofertën financiare, ofertuesit duhet të deklarojnë burimin e fondeve që do të përdoren për pagimin e çmimit të ofruar, dhe METE do të ketë të drejtën, në rastet kur e konsideron të nevojshme, të kryejë verifikime në lidhje me burimin e këtyre fondeve.

Forma dhe përmbajtja e ofertës financiare do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.11 Sigurimi i ofertës

Si pjesë e ofertës financiare, ofertuesi duhet të paraqesë edhe garanci për sigurimin e ofertës në

favor të METE-s, në vlerën e 10,000,000 (dhjetë milionë) euro “Sigurimi i ofertës”.

Sigurimi i ofertës do të jetë një letër garancie e lëshuar nga një bankë apo institucion financiar me reputacion dhe me aftësi paguese. Nëse institucioni që e lëshon sigurimin e ofertës është i themeluar jashtë Shqipërisë, sigurimi i ofertës duhet të lëshohet nga një degë shqiptare me reputacion dhe aftësi paguese ose një bankë korrespondente e themeluar në Shqipëri për ta bërë atë të zbatueshme.

Ofertuesit duhet të garantojë që sigurimi i ofertës do të qëndrojë i vlefshëm, për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës (sipas përcaktimit të paragrafit 6.2.1) dhe 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas çdo shtyrjeje afati të kërkuar nga METE në përputhje me paragrafin 6.2.2.

Ofertuesit fitues i kërkohet që të garantojë që kushtet e sigurimit të ofertës të zgjaten dhe të kenë vlefshmëri për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas periudhës së realizimit të shitblerjes, identifikuar sipas draftit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, në fuqi sipas miratimit të METE-s në momentin e skadimit të afatit për paraqitjen e ofertave, nëse vlefshmëria fillestare e sigurimit të ofertës është më e shkurtër sesa kjo periudhë.

Çdo ofertë e pashoqëruar me një sigurim oferte si më sipër do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave si e pavlefshme. Sigurimi i ofertës i një ofertuesi që është një konsorcium, duhet të jetë në emër të të gjithë pjesëmarrësve të konsorciumit, të cilët paraqesin ofertën.

Qëllimi i sigurimit të ofertës është që të garantojë që ofertuesi fitues, brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike pas shpalljes së ofertuesit fitues, sipas përcaktimeve të paragrafit 9.6.1 do të zbatojë marrëveshjen për shitblerjen e aksioneve, thelbësisht sipas formës së draftit në fuqi miratuar nga METE brenda afatit të paraqitjes së ofertave, të nënshkruar nga ofertuesi në ofertën e tij teknike.

Forma dhe përmbajtja e sigurimit të ofertës do të miratohet nga METE së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.1.12 Paga e tarifës së suksesit nga ofertuesi fitues

Ofertuesi fitues do të ketë detyrimin të paguajë, përveç çmimit të ofruar, një vlerë prej 430,000 (katërqind e tridhjetë mijë) eurosh në llogarinë bankare të *International Finance Corporation* (IFC), si tarifë suksesi e pagueshme për këtë transaksion.

Zotimi i ofertuesit për të paguar tarifën e suksesit do të jetë pjesë e ofertës financiare, për t'u miratuar nga METE, së bashku me udhëzimet për ofertuesit.

6.2 Vlefshmëria e ofertave

6.2.1 Periudha e vlefshmërisë së ofertave

Ofertat do të mbeten të vlefshme për periudhën që vijon afatin për paraqitjen e ofertave, siç detajohet në udhëzimet për ofertuesit (përfshirë dhe shtojcat) të miratuara nga METE “Periudha e vlefshmërisë së ofertave”. Një ofertë e vlefshme për një periudhë më të shkurtër do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave si e papranueshme.

6.2.2 Zgjatjet e afatit

Në rrethana të veçanta, METE mund të kërkojë miratimin e ofertuesve, të cilët kanë paraqitur një ofertë, për një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Kërkesa dhe përgjigjet e tilla duhet të bëhen me shkrim. Nëse ofertuesit pranojnë të zgjasin afatin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, sigurimi i ofertës duhet të zgjatet në përputhje me paragrafin e mësipërm 6.1.11 (dhe ofertuesit do të bëjnë përpjekjet e arsyeshme për këtë qëllim). Një ofertues mund të refuzojë kërkesën e METE-s për zgjatjen e afatit pa humbur sigurimin e tij të ofertës. Një ofertuesi, i cili e pranon kërkesën, nuk do t'i kërkohet dhe as nuk do t'i lejohet që të ndryshojë ofertën e tij.

6.3 Formati dhe nënshkrimi i ofertave

Ofertuesi duhet të përgatisë një ofertë në origjinal dhe me një numër kopjesh sipas përcaktimeve të udhëzimeve për ofertuesit, duke shënuar në mënyrë të dukshme secilën, si origjinale apo, si: kopja nr. 1; kopja nr. 2 etj. Në raste mospërputhjes midis origjinalit dhe kopjeve, origjinali do të mbizotërojë.

Oferta në origjinal dhe të gjitha kopjet e ofertës do të nënshkruhen nga ofertuesi (ose nëse ofertuesi është një konsorcium, nga të gjithë pjesëmarrësit e konsorciumit) ose nga personi(at) e autorizuar rregullisht për të paraqitur ofertuesin/konsorciumin. Një autorizim i tillë duhet të dëshmohet nga një prokurë përfaqësimi me shkrim, e paraqitur si pjesë e ofertës teknike, në përputhje me paragrafin

6.1.5. Të gjitha faqet e ofertës, me përjashtim të literaturës së paraprintuar, duhet të nënshkruhet nga personi apo personat, të cilët paraqesin këtë ofertë.

7. OFERTAT: PARAQITJA

7.1 Vulosja dhe shënjimi i ofertave

7.1.1 Zarfet e brendshme

Ofertuesi duhet të mbyllë ofertën teknike dhe financiare për shoqërinë objekt, në zarfe të veçanta të vulosura, duke shënuar mbi këto zarfe:

Në një zarf të brendshëm të mbyllur, ku të jenë shënuar fjalët:

i) “OFERTË TEKNIKE – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ-SHKOPET SHA”, zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e listuara në paragrafin 6.1.2 që përbëjnë ofertën teknike të ofertuesit për – “HEC ULËZ-SHKOPET SHA”; dhe

Në një zarf të brendshëm të mbyllur, ku të jenë shënuar fjalët:

ii) “OFERTË FINANCIARE – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ-SHKOPET SHA”, zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e listuara në paragrafin 6.1.3 që përbëjnë ofertën financiare të ofertuesit për “HEC ULËZ-SHKOPET SHA”.

7.1.2 Origjinali dhe kopjet

Zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafin 7.1.1 më sipër, duhet të përgatiten në një origjinal dhe një numër kopjesh, siç kërkohet në udhëzimet për ofertuesit. Zarfet që përmbajnë origjinalin dhe secilën kopje të ofertës teknike dhe financiare duhet të futen në zarfe të veçanta, ku të jenë shënuar fjalët:

“OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E ULËZ-SHKOPET SH.A. – ORIGINAL” / OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E ULËZ-SHKOPET SH.A.” – KOPJA NR. 1”; “OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ-SHKOPET SH.A. - KOPJA NR. 2”, e kështu me radhë.

7.1.3 Zarfet e jashtme

Zarfet e përshkruara në paragrafin 7.1.2 më sipër, duhet të vendosen në një zarf të veçantë të jashtëm të mbyllur, ku të shënohet:

“OFERTË – PËR PRIVATIZIMIN E HEC ULËZ-SHKOPET SHA”.

Zarfi i jashtëm i përshkruar në paragrafin 7.1.3 duhet të mbyllet dhe t’i dërgohet METE-s në adresën e dhënë në udhëzimet për ofertuesit dhe, gjithashtu, duhet të shënohen me fjalët “MOS HAPET PËRPARA DATËS _____.____.2012, ____:____am/pm, ora e Tiranës”, për t’u plotësuar me afatin e paraqitjes së ofertave, siç është përcaktuar më poshtë në paragrafin 7.2 dhe në udhëzimet për ofertuesit.

7.1.4 Identifikimi i ofertuesit

Zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafët 7.1.1 dhe 7.1.2 më sipër, duhet të kenë të shënuar secili, emrin dhe adresën e ofertuesit (ose nëse ofertuesi është një konsorcium, secilin pjesëmarrës të konsorciumit), në mënyrë që zarfet që përmbajnë ofertat teknike dhe financiare, siç janë përshkruar në paragrafët 7.1.1 dhe 7.1.2, të mund të kthehen të pahapur, siç parashikohet në paragrafin 8.5.3.

Nëse zarfi i jashtëm, përshkruar në paragrafin 7.1.3 nuk është mbyllur dhe shënuar, siç kërkohet më sipër, METE nuk do të mbajë përgjegjësi për ruajtjen e gabuar të zarfit të ofertës apo hapjen gabimisht të zarfit në mënyrë të parakohshme. Nëse zarfi i jashtëm tregon identitetin e ofertuesit, METE nuk garanton anonimitetin e dërgesës së ofertës, por ky identifikim nuk do të përbëjë arsye për refuzimin e ofertës.

7.1.5 Ofertat në mospërputhje

Çdo ofertë që nuk zbaton udhëzimet specifike në paragrafët e mësipërm të paragrafit 7, do të deklarohet në mospërputhje me dokumentet e ofertës dhe do të refuzohet nga komisioni i vlerësimit të ofertës.

7.2 Afati i paraqitjes së ofertave

7.2.1 Afati i paraqitjes së ofertave

Ofertat duhet të merren nga METE në adresën e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit, jo më vonë se në orën dhe në datën e përcaktuar në udhëzimet për ofertuesit si “Afati i paraqitjes së ofertave”.

7.2.2 Zgjatjet e afatit

METE, në diskrecionin e saj, mund të zgjasë afatin e paraqitjes së ofertave, duke ndryshuar

udhëzimet për ofertuesit, si dhe duke njoftuar ofertuesit në përputhje me paragrafin 5.3, në këtë rast të gjitha të drejtat dhe detyrimet e METE-s dhe ofertuesve do të jenë subjekte të afatit të zgjatur.

7.3 Ofertat e vonuara

Çdo ofertë e marrë nga METE pas afatit të paraqitjes së ofertave do të refuzohet dhe do t'i kthehet e pahapur ofertuesit, siç është parashikuar në paragrafin 8.5.3.

7.4 Ndryshimet dhe tërheqja e ofertave

Ofertuesi nuk mund të ndryshojë ofertën e tij pas dërgimit të saj. Ofertuesi që dëshiron të tërheqë ofertën tij duhet të njoftojë me shkrim METE-n, njoftim, i cili duhet të merret nga METE përpara afatit për paraqitjen e ofertave. Njoftimi i tërheqjes “Njoftim për tërheqje” duhet t'i dërgohet METE-s në adresën e deklaruar në udhëzimet për ofertuesit; dhe të ketë këtë lëndë:

- RE: “NJOFTIM PËR TËRHEQJE TË OFERTËS – PËR PRIVATIZIMIN E ULËZ-SHKOPET SHA”.

Çdo njoftim për tërheqje, i marrë pas afatit për paraqitjen e ofertave, do të injorohet dhe oferta e marrë dhe do të konsiderohet e dërguar rregullisht.

Çdo njoftim për tërheqje, i marrë në intervalin ndërmjet afatit për paraqitjen e ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës, përcaktuar në paragrafin 6.2, do të rezultojë në humbjen e sigurimit të ofertës së ofertuesit, sipas paragrafit 6.1.11.

8. OFERTAT: HAPJA DHE VLERËSIMI

Procedurat e hapjes dhe vlerësimit të ofertave sipas paragrafit 8 do të jenë publike dhe do të realizohen nga komisioni për vlerësimin e ofertave në datën, orën dhe vendin e treguar në udhëzimet për ofertuesit. Nëse procedurat e hapjes dhe vlerësimit nuk mund të përfundohen brenda së njëjtës ditë, atëherë procesi do të shtyhet dhe rifillohet ditën e ardhshme të punës në të njëjtën orë dhe vend (përveç kur njoftohet ndryshe nga komisioni për vlerësimin e ofertave). Prania e pjesëmarrësve në momentin e hapjes mund të kufizohet për shkak të hapësirës fizike të disponueshme, me kusht që gjithsesi, pjesëmarrja e të paktën e dy përfaqësuesve të secilit ofertues që ka dërguar ofertën të jetë e garantuar në çdo rast.

8.1 Hapja e zarfeve të jashtme

Përfaqësuesi(t) e ofertuesve që janë të pranishëm gjatë procedurave të hapjes dhe vlerësimit, duhet të nënshkruajnë një regjistër, i cili vërteton pjesëmarrjen e tyre.

Asnjë ofertë nuk do të refuzohet në hapjen e zarfeve, me përjashtim të ofertave të vonuara në përputhje me paragrafin 7.3.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të hapë njëkohësisht të gjitha zarfet e jashtme të mbyllura të përshkruara në paragrafin 7.1.3 dhe do të lexojë me zë të lartë, në prani të përfaqësuesit(ve) të ofertuesve, emrin dhe adresën e secilit ofertues që ka paraqitur ofertën, duke përfshirë dhe faktin nëse oferta është marrë brenda afatit për paraqitjen e ofertave në përputhje me udhëzimet për ofertuesit.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të hapë njëkohësisht të gjitha njoftimet për tërheqje në përputhje me paragrafin 7.4 dhe do të lexojë me zë, në prani të përfaqësuesit(ve) të ofertuesve, emrin dhe adresën e secilit ofertues që ka paraqitur njoftimin për tërheqje, duke përfshirë dhe faktin nëse njoftimi për tërheqje është marrë brenda afatit për paraqitjen e ofertave në përputhje me udhëzimet për ofertuesit.

8.2 Regjistrimi i rezultatit të hapjes

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të regjistrojë:

1. Numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra;
2. Numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra pas afatit për paraqitjen e ofertave;
3. Numrin total të ofertave dhe njoftimeve për tërheqje të marra brenda afatit për paraqitjen e ofertave.

8.3 Hapja dhe vlerësimi i zarfeve të brendshme

Menjëherë pas përfundimit të procedurave të hapjes, sipas paragrafit 8.1, në lidhje vetëm me ofertat sipas pikës 3 të paragrafit 8.2 më sipër, në lidhje me të cilat nuk është marrë një njoftim për tërheqje, komisioni i vlerësimit të ofertës do të hapë njëkohësisht:

1. Zarfet e përshkruara në paragrafin 7.1.3 që përmbajnë kopjen origjinale të ofertave; dhe

2. Zarfet e brendshme përkatëse të tyre, të përshkruara në paragrafin 7.1.1(i), që përmbajnë kopjet origjinale të ofertave teknike.

8.4 Ofertat teknike

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të lexojë me zë, në praninë e përfaqësuesit(ve) të ofertuesit dhe do të regjistrojë përmbajtjen e secilës ofertë teknike të hapur në zbatim të paragrafit 8.3.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të procedojë fillimisht në lidhje me një shoqëri objekt dhe më pas për shoqërinë tjetër objekt, pa ndonjë rend të veçantë.

8.4.1 Kontrolli i përputhshmërisë

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të shqyrtojë dokumentet që gjenden në zarfet e ofertave teknike të hapura sipas paragrafit 8.3 dhe do të përcaktojë nëse janë të plota, thelbësisht e formalisht në përputhje me këto procedura tenderi, si dhe me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat).

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të sigurojë veçanërisht që dokumentet e ofertës teknike të përputhen me kërkesat e paragrafit 6.1.2 dhe të udhëzimeve për ofertuesin (përfshirë shtojcat) dhe që ofertuesit vazhdojnë të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 më sipër. Komisioni për vlerësimin e ofertave do të sigurojë, gjithashtu, që formulimi i draft marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve të përputhet me versionin përfundimtar të marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve, dërguar ofertuesve përpara afatit për paraqitjen e ofertave.

8.4.2 Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i ofertave teknike do të bazohet në kriterin *kalon ose nuk kalon*, dhe nuk do të kryhet vlerësim me pikë për ofertat teknike.

Ofertat teknike që nuk përmbushin kërkesat minimale të paragrafit 8.4.1 më sipër do të deklarohen si të pavlefshme ose në mospërputhje me dokumentet e ofertës sipas rastit dhe do të refuzohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

8.4.3 Ofertat e kualifikuara

Komisioni i vlerësimit të ofertave më pas do të deklarojë, në praninë e përfaqësuesit(ve) të ofertuesve, dhe do të regjistrojë emrin dhe adresën e secilit ofertues që kalon kontrollin e përputhshmërisë së ofertave teknike sipas paragrafit 8.4.1.

8.5 Ofertat financiare

8.5.1 Hapja dhe përputhshmëria formale

Komisioni i vlerësimit të ofertave, vetëm për ofertat që kanë kaluar kontrollin e përputhshmërisë sipas paragrafit 8.4.1 do të hapë zarfet e brendshme të përshkruara në paragrafin 7.1.1(ii) që përmbajnë ofertat financiare që rezultojnë nga procedura e hapjes sipas paragrafit 8.3.

Asnjë ofertë financiare nuk do të hapet nëse oferta teknike e ofertuesit përkatës nuk ka kaluar kontrollin e përputhshmërisë sipas paragrafit 8.4.1.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të lexojë me zë të lartë, në prani të përfaqësuesit(ve) të ofertuesve, dhe do të regjistrojë përmbajtjen e secilës ofertë financiare të hapur sipas paragrafit 8.5.1.

8.5.2 Çmimi i ofruar

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të shqyrtojë pajtueshmërinë e dokumenteve që përbëjnë ofertën financiare me kërkesat e këtyre procedurave të tenderit, si dhe me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat) dhe nëse gjenden në pajtim me to, në prani të përfaqësuesit(ve) të ofertuesve do të lexojë me zë shumën e çmimit të ofruar nga secili ofertues.

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të regjistrojë emrin dhe adresën e secilit ofertues që ka dërguar një ofertë financiare të vlefshme, së bashku me çmimin e ofruar nga ofertuesi.

8.5.3 Kthimi i dokumenteve

Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e përfundimit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave sipas paragrafit 8, komisioni për vlerësimin e ofertave do të njoftojë zyrtarisht me shkrim ofertuesit, ofertat e të cilëve janë deklaruar të vonuara, të pavlefshme dhe/ose në mospërputhje me procedurat dhe/ose me udhëzimet për ofertuesit (përfshirë shtojcat), për vendimin përfundimtar për përjashtimin e ofertuesit nga procedurat e mëtejshme të procesit të ofertës.

Së bashku me këto njoftime, komisioni për vlerësimin e ofertave, gjithashtu, do të kthejë zarfet e ofertuesve të përshkruara në paragrafin 7.1.1, 7.1.2 dhe 7.1.3, të cilat ishin të pahapura kur oferta u

deklarua e tërhequr, e vonuar, e pavlefshme dhe/ose në mospërputhje, sipas rastit.

9. PROCEDURAT E MËTEJSHME

9.1 Pavlefshmëria dhe dështimi i procesit të tenderimit

Komisioni për vlerësimin e ofertave mund të tolerojë informalitete, mospërputhje ose parregullsi të vogla në një ofertë, të cilat nuk përbëjnë ndryshim material dhe që nuk paragjykojnë ose ndikojnë renditjen përkatëse të secilit ofertues si pasojë e vlerësimit të ofertës teknike dhe ofertës financiare.

9.1.1 Oferta të pavlefshme

Përveç rasteve të tjera të parashikuara shprehimisht, një ofertë do të deklarohet e pavlefshme kur:

1. Ofertuesi nuk ka dhënë sigurimin e ofertës;
2. Ofertuesi ka shkelur konfidencialitetin ose ka dhënë të dhëna të pavërteta në ofertën e tij/saj;
3. Ofertuesi nuk ka përmbushur ndonjë nga kërkesat e udhëzimeve për ofertuesit dhe dokumente të tjera të ofertës.

9.1.2 Dështimi i procesit të tenderimit

Procesi i tenderimit konsiderohet i pasuksesshëm, e për pasojë i dështuar, nëse:

1. asnjë nga ofertat nuk përmbush kërkesat e udhëzimeve për ofertuesit dhe dokumentet e tjera të ofertës;

2. Këshilli i Ministrave vendos të përfundojë procesin e tenderimit; ose

3. nuk është paraqitur asnjë ofertë.

9.2 Raporti i vlerësimit dhe njoftimi i ofertuesve

Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të procedurës sipas paragrafit 8, kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave përgatit një raport përmbledhës “Raporti i vlerësimit”, i cili përmban:

1. Objektin e procesit të tenderimit dhe përqindjen e aksioneve të ofruara për shitje për shoqërinë objekt;

2. Një përmbledhje të shkurtër të procedurës dhe të numrit të ofertave të dërguara për shoqërinë objekt;

3. Një përmbledhje të ofertave të dërguara për shoqërinë objekt;

4. Kriteret kryesore për vlerësimin e ofertave, dhe të vlerësimit të kryer për secilën ofertë për shoqërinë objekt;

5. Kriteret e vlerësimit për ofertat financiare; dhe

6. Një renditje të ofertuesve sipas çmimit të ofruar për shoqërinë objekt.

Raporti i vlerësimit paraqitet pranë METE-s për t’u dërguar më tej pranë Këshillit të Ministrave së bashku me propozimin e ofertuesit që ka propozuar çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt sipas paragrafit 8.5.2.

9.3 Miratimi/refuzimi nga Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave shqyrton raportin e vlerësimit të propozuar nga komisioni për vlerësimin e ofertave dhe me diskrecion të tij:

1. Miraton raportin e vlerësimit dhe ofertën me çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt; ose

2. Miraton raportin e vlerësimit, por refuzon ofertën me çmimin e ofruar më të lartë për shoqërinë objekt nëse oferta financiare konsiderohet pa interes ekonomik; ose

3. Refuzon raportin e vlerësimit dhe kërkon korrigjime. Në këtë rast, komisioni i vlerësimit të ofertave bën korrigjimet e nevojshme, dhe raporti i vlerësimit paraqitet përsëri për miratim në përputhje me paragrafin 9.3.

Në vijim të miratimit nga Këshilli i Ministrave sipas pikave (1) më sipër, METE fiton të drejtën për të nënshkruar marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve me ofertuesin fitues, sipas paragrafit 9.5 më poshtë.

9.4 Përfundimi i procesit të tenderimit

Këshilli i Ministrave, në çdo kohë përpara shpalljes së ofertuesve fitues, mund të përfundojë procesin e tenderimit pa u dhënë ofertuesve asnjë argument justifikues.

METE nuk mban asnjë përgjegjësi në ushtrimin e ndonjë të drejte sipas këtij paragrafi.

9.5 Paragrafët përfundimtarë

9.5.1 Njoftimi i ofertuesit fitues

METE, në lidhje me shoqërinë objekt, i dërgon njoftimin e ofertuesit fitues, ofertuesit, oferta e të cilit është pranuar nga Këshilli i Ministrave sipas paragrafit 9.3 “Ofertuesi fitues”. Ofertuesi fitues ftohet për të ndjekur procedurat vijuese për finalizimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve dhe për nënshkrimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e miratimit të ofertuesit fitues nga Këshilli i Ministrave. Ofertuesi fitues mbetet i detyruar të zbatojë marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, sipas kopjeve të nënshkruara si pjesë e ofertës teknike, pa cenuar të drejtën e METE-s për të vendosur ndryshime të vogla, me qëllim qartësimin dhe finalizimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve.

Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit si më sipër, ofertuesi fitues nuk zbaton kërkesat për zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës sipas paragrafit 6.1.10, nëse kjo zgjatja është nevojshme, dhe/ose nuk nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, METE ka të drejtë të tërheqë sigurimin e ofertës së ofertuesit fitues dhe të ftojë ofertuesit e tjerë të radhës, që kanë paraqitur një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.5.2, sipas renditjes së raportit të miratuar të vlerësimit, derisa marrëveshja e shitblerjes së aksioneve të nënshkruhet, ose i propozon Këshillit të Ministrave të përfundojë procesin e tenderimit.

9.6 Kontaktimi me METE-n ose me autoritetet

Duke nisur nga momenti i hapjes së ofertave e deri në momentin e zbatimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, nëse ndonjë ofertues dëshiron të kontaktojë METE-n, duhet ta bëjë nëpërmjet *e-mail*-it në adresën e përcaktuar në udhëzimin e METE-s, si dhe një kopje të çdo korrespondence dërguar grupit të projektit IFC: albaniahpps@ifc.org.

9.6.1 Finalizimi i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve

Finalizimi i marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve me ofertuesin fitues do të kryhet me asistencën e *International Finance Corporation* (IFC).

Me nënshkrimin e marrëveshjes e shitblerjes së aksioneve nga ofertuesi fitues, METE do të njoftojë menjëherë me shkrim, sipas udhëzimeve për ofertuesit (përfshi shtojcat), çdo ofertues tjetër që ka dërguar një ofertë financiare të vlefshme sipas paragrafit 8.5.2.

9.7 Kthimi i ofertës dhe konfiskimi

METE do të kthejë sigurimin e ofertës së ofertuesve të pasuksesshëm, që kanë paraqitur një ofertë financiare të vlefshme, sipas paragrafit 8.5.2, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas mbarimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës, siç është përcaktuar në paragrafin 6.2.1 dhe, siç mund të shtyhet në përputhje me paragrafin 6.2.2.

Sigurimi i ofertës i ofertuesit fitues (sipas paragrafit 9.5) do të kthehet me përfundimin e afatit të realizimit të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve nënshkruar mes palëve.

Sigurimi i ofertës mund të tërhiqet, me diskrecion të METE-s:

- Nëse ofertuesi (ose çdo anëtar i konsorciumit) bën ndonjë deklaram të pavërtetë material në ofertën e tij;

- Nëse ofertuesi tërheq ofertën gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertës;

- Nëse ofertuesi fitues nuk zbaton kërkesat për zgjatjen e afatit të sigurimit të ofertës, sipas paragrafit 6.1.10, nëse kjo zgjatja është nevojshme, dhe/ose nuk nënshkruan marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve në formën e kopjes së nënshkruar, përfshirë në ofertën e tij, në një datë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas shpalljes së ofertuesit fitues sipas 9.5.1; ose

- Nëse ofertuesi fitues nuk arrin të realizojë marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, për arsye që i atribuohen ofertuesit fitues.

Sigurimi i ofertës bëhet i tërheqshëm me kërkesën e parë të METE-s në rast se verifikohen një apo më shumë nga rrethanat e përshkruara në këtë paragraf.

Konfiskimi i sigurimit të ofertës nuk pengon METE që të marrë masa të tjera kundër ofertuesit fitues ose ndonjë ofertuesi tjetër.

Për më tepër, nëse një ofertues ose ofertuesi fitues: i) përdor mashtrimin e në marrëdhëniet me METE-n, komisionin për vlerësimin e ofertave, këshilltarët e tij, punëmarrësit, konsulentët ose agjentët në lidhje me projektin; ose ii) provohet se, personalisht apo nëpërmjet një ndërmjetësi, direkt apo indirekt, ka ofruar ose është munduar të ofrojë ryshfet për ndonjë nga punëmarrësit e METE-s të përfshirë në ofertë ose në projekt, atëherë oferta e ofertuesit, ose ofertuesit fitues do të anulohen dhe sigurimi i ofertës do të konfiskohet.

9.8 Konfidencialiteti

METE dhe komisioni për vlerësimin e ofertave do të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha të dhënave teknike, ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga ofertat. Përveçse nëse parashikohet ndryshe nga ligji, vendimi i gjykatës ose nga udhëzimet për ofertuesin, METE dhe ofertuesit nuk do t'u shpërndajnë asnjë pale të tretë, informacione apo të dhëna teknike mbi çmimin dhe çdo element tjetër subjekt të diskutimeve, pa lejen e palës tjetër, me përjashtim të këshilltarëve dhe konsulentëve në lidhje me projektin.

9.9 Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së shitjes së aksioneve

Pas nënshkrimit nga METE dhe nga ofertuesit fitues, marrëveshja e shitjes së 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare "Hec Ulëz-Shkopet sh.a." dhe miratohet nga Kuvendi, bazuar në propozimin e Këshillit të Ministrave.